



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 620 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

VENDIM

Nr. 520, datë 06.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks rezidencia “Park Houses” me objekte banimi me struktura 1, 2 dhe 3 kate mbi tokë, me 1 – 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Mjull-Bathore, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjekti “EBG” sh.p.k;
 2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2 nga DRTK Tiranë dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, referuar nenit 145-147;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

KRYETAR
Blendi GONXHJA